

Sekondat që shpëtojnë (apo marrin) jetë!

Tash e një kohë të gjatë më mundon shumë fakti se sa jetë janë humbur e sa janë duke u humbur në komunikacionin rrugor të Kosovës (sipas statistikave vetëm në muajin shkurt të këtij viti 18 të vdekur). Sa lëndime kanë pësuar njerëzit, sa dëme janë shkaktuar, e me sa e sa vuarjtje janë duke u përcjellë te gjitha këto, pavarësisht angazhimeve shumë të mëdha të policisë sonë, asaj ndërkombëtare, të KFOR-it përmes patrullave të shumta, duke kontrolluar, këshilluar, duke shqiptuar dënime etj. Prandaj, mora iniciativën që me përkrahjen tuaj, ta adresoj shumë thjesht, po me rëndësi tejet të madhe, këtë çështje kaq qenësore në lëvizjet tona të përditshme. Komunikacioni në përgjithësi, qoftë ai ujqor, hekurudhor, ajror apo rrugor është një fushë që të gjithëve na e bën të mundshëm realizimin më të shpejtë dhe më të lehtë të detyrave, të obligimeve e në përgjithësi të qëllimeve tona, por asnjëherë nuk duhet harruar që ai mjet qarkullimi qoftë veturë, autobus, mjet transportues, skuter etj... drejtohet nga ne, nga shoferi! Është e dhembshme që ngan-

jëherë disa shoferë mendojnë, madje shfaqin superioritetin e tyre, kinse është shofer 'i fortë', s'ka më të mirë etj., e që jo rrallë të njëjtit rezultojnë me marrjen e jetëve të pafajshme të bashkëpjesëmarrësve në komunikacion. Në mënyrën më serioze, apeloj që të gjithë ne të cilët drejtojmë mjetin duhet të kemi parasysh në shpejtësinë e lëvizjes e veçanërisht gjatë natës, gjatë qarkullimit afër shkollave, gjatë qarkullimit afër vendbanimeve dhe në vende ku fëmijët luajnë. Ne e dimë (do të duhej të paktën) që duhet shumëçka të shpjegohet për komunikacionin, por me qëllim që kjo shkresë mos t'ju marrë shumë kohë unë tani në vijim do të mundohem që të shkruaj disa fjalë për distancën e ndaljes dhe duke marrë shembuj për të cilën besoj se është esenciale dhe që ju do të përfitonit duke menduar për këtë dhe që përmes këtyre udhëzimeve do të jeni pjesë e shoferëve 'të fortë' e të sigurt në rrugët tona (edhe ashtu të pasigurta). Nëse shoferi duhet ta ndalë veturën në rast urgjent patjetër duhet të kalojë nëpër kohën e reagimit, kohë kjo e cila përmban:

1. Fazën e perceptimit (fazë kjo që

voztësi fillimisht e sheh situatën e sheh rrezikun).

2. Fazën e vlerësimit (fazë kjo kur shoferi merr vendimin për të frenuar),
3. Fazën e veprimit (fazë kjo kur shoferi e shtyp pedalën e frenit) dhe përfundimisht distanca e frenimit....atëherë kur frenat hyjnë në funksion!

Në mënyrë që këtë ta thjeshtësojmë, në realitet apo në rrugë kjo do të dukej kështu: Shoferi i kujdesshëm, i cili nuk pengohet nga bashkudhëtarët dhe që është i përqendruar në ngasje, që nuk përdor telefonin, që nuk është i lodhur, që përshat shpejtësinë sipas rregullave e sipas kushteve qoftë ato atmosferike apo rrugore, ka kohën e reagimit 1 sekondë dhe nëse atij i paraqitet ndonjë rrezik në rrugë në largësi 60 metra, përderisa ai zhvillon shpejtësinë 70 km/h, ai fillimisht para se të frenojë do të kalojë kohën e reagimit e që në këtë rast është 20 metra gjë që e bën atë t'i afrohet rrezikut për aq dhe më pas do të frenojë e që në të shumtën e rasteve, bazuar edhe në hulumtime të shumta ai do t'i shmanget rrezikut, sepse i mbeten edhe 40 metra për frenim

në ato kushte. Në situatën tjetër (gjë që shpresoj se nuk do të kemi këso raste, apo do të kemi fare pak në të ardhmen, por tani kemi shumë fatkeqësisht) ndodh kjo: Shoferi jo i kujdesshëm, pengohet nga bashkudhëtarët, nuk është i përqendruar në ngasje, përdor telefonin, vendos ndonjë CD apo vështron shpeshherë CD-plejerin, është i lodhur, nuk përshatë shpejtësinë sipas rregullave apo sipas kushteve të rrugës, ngutet, ka kohën e reagimit 2 e shpeshherë edhe 3 sekonda, dhe nëse atij i paraqitet ndonjë rrezik në rrugë në largësi 60 metra përderisa ai

zhvillon shpejtësinë (shpresojmë jo më shumë se) 80 Km/h, ai fillimisht para se të frenojë do të kalojë kohën e reagimit e që në këtë rast është më së paku 44 metra (2 sekonda shumëzuar me 22 metra) gjë që e bën atë t'i afrohet rrezikut për aq dhe më pas do të frenojë e që në të shumtën e rasteve, bazuar prapë në statistika e hulumtime, por edhe nga logjika e shëndoshë ai nuk mundet t'i shmanget rrezikut, sepse i mbeten vetëm 20 metra për frenim në ato kushte.

Gazmend Preteni, njohës i komunikacionit rrugor

Informata të dobishme

Distanca e ndaljes = Kohën e reagimit + Distancën e frenimit

Koha e reagimit 1 sekondë e shprehur në metra: Koha e reagimit 2 sekonda e shprehur në metra

20 Km/h, 5.5 m	20 Km/h, 11 m
30 Km/h, 8.3 m	30 Km/h, 16.6 m
40 Km/h, 11 m	40 Km/h, 22 m
50 Km/h, 13 m	50 Km/h, 26 m
60 Km/h, 16 m	60 Km/h, 32 m
70 Km/h, 19.4 m	70 Km/h, 38.8 m
80 Km/h, 22 m	80 Km/h, 44 m
90 Km/h, 25 m	90 Km/h, 50 m

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.